



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT
DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT

Nr. 4655, Prot

Tiranë, më 27.09.2024

L ë n d a: *Dërgojmë, raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2024,*

MINISTRISË SË FINANCAVE,
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT,
DREJTORISË SË ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR,

T I R A N Ë.

Në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ju përcjellim, raportin dhe anekset e monitorimeve të buxhetit për periudhën janar- gusht 2024, gjeneruar nga sistemi AFMIS, për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor si më poshtë;

ANEKSI nr. 1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor.

ANEKSI nr. 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve.

ANEKSI nr.1.2 Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor

ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit (për të tre programet buxhetore 01110, 01140, dhe 03310).

RAPORTI nr. 2/1 - Shpenzimet e programit sipas kapitujve (për të tre programet buxhetore 01110, 01140, dhe 03310).

ANEKSI nr. 3 Raporti i performancës së produkteve të programit (për të tre programet buxhetore 01110, 01140, dhe 03310).

ANEKSI nr. 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve (për të tre programet buxhetore 01110, 01140, dhe 03310).

ANEKSI nr. 3.2 Deviacioni kostos për njësi në vite (për të tre programet buxhetore 01110, 01140, dhe 03310).

ANEKSI nr. 4 Raporti i realizimit të treguesve të performances së programit (për të tre programet buxhetore 01110, 01140, dhe 03310).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM





KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT

Raporti i Monitorimit të Buxhetit

8 mujori
i vitit 2024

Këshilli i Lartë Gjyqësor

2021

2022

2023

2024

27 SHTATOR 2024

Me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2024, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2024, janë miratuar në tre programe buxhetore:

- Programi buxhetor 01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Programi buxhetor 01140, “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.
- Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Buxheti i miratuar me ligjin 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, për të tre programet buxhetore në fillim të vitit ishte në shumën 4,967,459, 000 lekë, i ndarë përkatësisht:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën 381,059,000 lekë,
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në shumën 16,800,000 lekë,
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në shumën 4,569,600,000 lekë.

Buxheti i miratuar për vitin 2024, krahasuar me buxhetin e realizuar për vitin 2023, është më i lartë në masën 6.5%. Struktura e shpenzimeve të planifikuara (kundrejt totalit) në bazë programi, krahasuar me strukturën e shpenzimeve faktike të viti 2023, ka ndryshuar. Është rritur niveli i shpenzimeve të planifikuara për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” me 1% (nga 7% në 8%), ndërsa niveli i shpenzimeve të planifikuara për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” është zvogëluar me 1% (nga 93% në 92%).

Gjatë periudhës raportuese janar-gusht 2024, buxheti i grupit buxhetor është rishikuar (shtuar) në total në shumën 41,282,820 lekë, nga të cilat; 4,206,000 lekë në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”; 100,000 lekë në programin 01140 “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, ndërsa në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, është shtuar fondi në shumën 36,976,820 lekë si më poshtë:

1) Ministria e Financave me Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor në shumën 4,500,000 lekë. KLGJ me shkresën nr. 882, datë 08.02.2024, drejtuar Ministrisë së Financave, ka kërkuar detajimin e këtij fondi në:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën 1,200,000 lekë.
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në shumën 100,000 lekë.
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor”, në shumën 3,200,000 lekë.

Ministria e Financave me shkresën nr. 1351/1, datë 23.02.2024, ka miratuar këtë detajim, i cili është reflektuar në planet e secilit programit dhe në totalin e planit të grupit buxhetor.

2) Ministria e Financave ka miratuar me shkresën nr 2661/1 datë 20.03.2024 shtesën e fondit në artikullin 606, të programit 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shumën 276,820 lekë për

likujdimin e 2 pagave të funksionit për një ish - magjistratë, sipas kërkesës së KLGJ me shkresën nr. 1155/1, datë 27.02.2024.

3) Ministria e Financave me shkresën 9797/1 datë 30.07.2024, ka miratuar fondin shtesë në shumën 35,000,000 lekë, sipas kërkesës së KLGJ-së me shkresën 3647, datë 03.07.2024. Fondi është i nevojshëm për mbulimin e efektit financiar të ndryshimeve ligjore në paga në zbatim të VKM nr. 421 datë 26.06.2024 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 325, datë 31.05.2024 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar”. Fondi shtesë është akorduar në shpenzime personeli nga të cilat; në shumën 1,500,000 lekë në shpenzime për sigurime shoqërore (Art.601) programi 01110“Planifikim, menaxhim dhe administrim” dhe në shumën 33,500,000 lekë në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” në paga (Art.600).

4) Ministria e Financave ka miratuar me shkresën nr. 10738/1 datë 21.08.2024, kërkesën e KLGJ-së me shkresën nr. 4084/1, datë 02.08.2024, për një shtesë fondit në artikullin 606 të programit 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në shumën 1,506,000 lekë për likujdimin e 2 pagave të funksionit për 2 ish anëtarët e KLGJ.

Buxheti i rishikuar vjetor për grupin buxhetor për periudhën janar- gusht si rezultata i ndryshimeve të mësipërme është në shumën 5,008,741,820 lekë. Realizimi 8 mujor, si grup buxhetor është në shumën 2,794,006,812.81 lekë ose në masën 56%. Nga të cilat: programi 01110 në masën 55%; programi 01140 në masën 51% dhe programi 03310 në masën 56%.

Në nivel artikulli realizmi për grupin buxhetor paraqitet si më poshtë:

Artikulli 600 (paga) – Në këtë artikull, për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është detajuar në fillim të vitit, fondi në shumën 3,450,339,000 lekë. Gjatë periudhës janar – gusht ky buxhet është rishikuar (shtuar) në shumën 31,650,000 lekë nga të cilat:

- Shtesë fondi në shumën 33,500,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave, për mbulimin e fektit financiar në këtë artikull si rezultat i ndryshimeve ligjore në paga, me VKM 421 datë 26.06.2024, konkretisht në programin 03310 të këtij grupi buxhetor.

- Transferim (pakësim) fondi në shumën 1,850,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 6112/1, datë 27.05.2024, sipas kërkesës së KLGJ me shkresën nr. 2394 datë 29.04.2024. Fondi u transferua nga artikulli 600 (paga) e programit 01140 në artikullin 602 (shpenzime operative) të po këtij programi. Ky rishikim ishte i nevojshëm për mbulim e shpenzimeve për honorare bordi për anëtarët e Bordit Drejtues të QTI –së, pasi fondi i detajuar në fillim të vitit ishte i pamjaftueshëm, sikurse është bërë prezent edhe gjatë negociatave të PBA 2024-2026 nga përfaqësuesit e KLGJ.

- Buxheti i rishikuar vjetor në paga është 3,481,989,000 lekë. Realizimi për 8 mujorin e vitit 2024, është në shumën 2,084,870,400 lekë ose në masën 60% e buxhetit të rishikuar vjetor.

Artikulli 601 (Sig Shoqërore) – Në këtë artikull, për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është detajuar fondi në shumën 437,170,000 lekë, ndërsa buxheti i rishikuar vjetor është në shumën 438,670,000 lekë. Buxhetit është rishikuar si rezultat i shtesës së fondit në shumën 1,500,000 lekë për shkak të ndryshimeve ligjore në paga, VKM 421, datë 26.06.2024. Realizimi është 244,198,266 lekë ose në masën 56% e planit të rishikuar vjetor.

Realizimi në këtë masë i fondeve në shpenzime personeli, është i lidhur me vakancat e shumta në Sistemin Gjyqësor. Numri i punonjësve të Sistemit Gjyqësor i miratuar me ligj për vitin 2024, është 1,759 vetë, nga këto; 138 vetë janë punonjës të stafit të KLGJ-së, 6 vetë është numri i punonjësve të QTI-së, 1,615 vetë është organika e stafit gjyqësor. Numri faktik për periudhën janar- gusht 2024 për sistemin gjyqësor është 1,488 vetë, ose në masën 85%, ndërsa mungesat janë 271 vetë (30+1+240=271) nga të cilat; 30 janë vakancat në KLGJ, 1 është në QTI, 240 janë vakancat e përhershme në gjykata.

Numri i punonjësve të KLGJ-së, i miratuar me ligj është 138 punonjës ndërsa aktualisht janë 108 punonjës, pra ka mungesë me 30 punonjës.

Numri i punonjësve të miratuar me ligj për QTI –në, është 6 punonjës, ndërsa aktualisht janë 5 punonjës (Drejtori + 4 specialist), pra ka mungesë me 1 punonjës.

Për vitin 2024, numri i punonjësve të miratuar me ligj për programin “Buxheti Gjyqësor”, është 1,615 punonjës nga këto; 408 janë magjistratë dhe 1,207 janë punonjës të administratës gjyqësore, ndërsa faktikisht në 30 gusht në strukturat organike të gjykatave rezultojnë 1,375 punonjës (311 magjistratë dhe 1,064 janë punonjës të administratës).

Aktualisht në gjykata ka mungesa në strukturën organike me 240 punonjës; nga të cilët 97 janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe 143 janë punonjës të administratës. Ndërkohë nga 311 magjistratët, që rezultojnë efektivisht në detyrë 72 prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhen me 75% të pagës.

- Artikulli 602 (Mallra dhe shërbime të tjera) - Në këtë artikull, për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është detajuar fondi në shumën 689,326,000 lekë. Gjatë periudhës janar-gusht ky artikull është rishikuar në shumën 1,850,000 lekë. Është shtuar fondi në shumën 1,850,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 6112/1, datë 27.05.2024, sipas kërkesës së KLGJ me shkresën nr. 2394 datë 29.04.2024. Fondi u transferua nga artikulli 600 (paga) e programit 01140 në artikullin 602 (shpenzime operative) të po këtij programi. Ky rishikim ishte i nevojshëm për mbulim e shpenzimeve për honorare bordi për anëtarët e Bordit Drejtues të QTI –së, pasi fondi i detajuar në fillim të vitit ishte i pamjaftueshëm, sikurse është bërë prezent edhe gjatë negociatave të PBA 2024-2026 nga përfaqësuesit e KLGJ në MF.

Buxheti i rishikuar në këtë artikull për grupin buxhetor është në shumën 691,176,000 lekë, ndërsa realizimi për 8 mujorin e vitit 2024 është në shumën 330,928,156.8lekë ose në masën 48%. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të këtij grupi buxhetor me materiale e shërbime zyre, shpenzime për udhëtim e dieta. Janë kryer likuidimet e shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, energji elektrike, shpenzime transporti, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, dhe shpenzime të tjera speciale, si ekzekutime vendimesh gjyqësore, pagesa ekspert, psikolog e avokat, shpenzime për roje objekti, tatim taksa, etj.

Artikulli 606 (Trans. për Buxh. Fam. & Individ) - Fondi i detajuar në fillim të vitit në këtë artikull për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, ishte në shumën 7,624,000 lekë. Fondi u planifikua për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike, për përfituesit sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, i ndryshuar, si dhe mbulimin e shpenzimeve për pagesat e interesit të

kredisë për magjistratët përfitues të kredisë për banim sipas dispozitave ligjore në fuqi. Buxheti në këtë artikull është rishikuar si më poshtë:

- Ministria e Financave me Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor në shumën 4,500,000 lekë.

- Ministria e Financave ka miratuar me shkresën nr. 2661/1 datë 20.03.2024, kërkesën e KLGJ me shkresën nr. 1155/1, datë 27.02.2024, për një shtesë fondit në artikullin 606 të programit 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shumën 276,820 lekë për likuidimin e 2 pagave të funksionit për një ish - magjistratë.

- Ministria e Financave ka miratuar me shkresën nr. 10738/1 datë 21.08.2024, kërkesën e KLGJ me shkresën nr. 4084/1, datë 02.08.2024, për një shtesë fondit në artikullin 606 të programit 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në shumën 1,506,000 lekë për likuidimin e 2 pagave të funksionit për 2 ish anëtarët e KLGJ.

Buxheti i rishikuar vjetor për vitin 2024, si rezultat i shtesave të fondit në këtë artikull për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, është 13,906,820 lekë, ndërsa realizimi faktik është 3,822,267 lekë ose në masën 28% e buxhetit të rishikuar vjetor.

Në total për grupin buxhetor realizimi në shpenzime korrente për periudhën në fjalë sipas buxhetit të rishikuar vjetor në shumën 4,625,741,820 lekë, është në shumën 2,663,819,089.81lekë, është në masën 58% e buxhetit të rishikuar vjetor.

Artikulli 230-231 (Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm) - Fondi i programuar për shpenzime kapitale për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është vetëm me financim të brendshëm, në shumën 383,000,000 lekë, nga të cilat:

- Artikulli 230- (kapitale të patrupëzuara) është detajuar fondi në shumën 28,000,000 lekë. Fondi në këtë artikull nuk është realizuar.

- Artikulli 231- (kapitale të trupëzuara) është detajuar fondi në shumën 355,000,000 lekë, ndërsa realizimi gjatë 8 mujori në shumën 130,187,723 lekë ose në masën 37 % e buxhetit vjetor të programuar në këtë artikull.

Realizimi në shpenzime kapitale (Art. 230+231) nga 383,000,000 lekë të planifikuara është në shumën 130,187,723,lekë, ose në masën 34% të tij. KLGJ dhe gjykatat vijojnë procedurat e prokurimit dhe realizimit të fondit.

Përveç fondeve buxhetore, gjykatat në zbatim të VKM nr. 432, datë 08.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore” si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore”, kanë përdorur edhe një pjesë të të ardhurave të krijuara prej tyre. Për periudhën raportuese, realizimi i shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit (vetëm për programin 03310 - Buxheti Gjyqësor) është në shumën 4,858,166 lekë. (Aneksi 1 dhe 1/1).

Në mënyrë analitike performanca e buxhetit në nivel programi paraqitet si më poshtë (Aneksi 1,2 ;2 dhe 2/1):

I- Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Buxheti i alokuar me ligjin e buxhetit për programin 01110 - Planifikim, menaxhim dhe administrim të grupit buxhetor “Këshillin e Lartë Gjyqësor” në fillim të vitit 2024 ishte në shumën 381,059,000 lekë, i detajuar përkatësisht në shumën 366,059,000 lekë në shpenzime korrente dhe 15,000,000 lekë në shpenzime kapitale të trupëzuara (artikulli 231).

Buxheti, është rishikuar në këtë program si rezultat i shtesave të fondeve në shumën 4,206,000 lekë, si më poshtë:

- Akordim të fondit të veçantë (art 606) në shumën 1,200,000 lekë nga Ministria e Financave me shkresën nr. 1351/1, datë 23.02.2024.

- Akordim fondi shtesë në shumën 1,500,000 lekë. Fondi ishte i nevojshëm për mbulimin e efektit financiare të rritjes së shpenzimeve në sigurimet shoqërore (art 601) si rezultat i ndryshimeve ligjore në paga, VKM 421, datë 26.06.2024.

- Akordim shtesë fondit në artikullin 606 të programit 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në shumën 1,506,000 lekë për likuidimin e 2 pagave të funksionit për 2 ish anëtarët e KLGJ. (sikurse kemi cituar në shkresat më lart)

Buxheti i rishikuar vjetor, është në shumën 385,265,000 lekë, nga të cilat; 370,265,000 lekë në shpenzime korrente dhe 15,000,000 lekë në investime.

Realizimi faktik për periudhën raportuese është në shumën 210,269,318 lekë ose në masën 55% kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor, nga të cilat; 195,887,928 lekë në shpenzime korrente, ose në masën 53% dhe 14,381,390 lekë në shpenzime kapitale ose në masën 96%.

“Artikulli 600” - Buxheti vjetor i detajuar në “*Shpenzime paga*” për këtë program është në shumën 256,639,000 lekë dhe realizimi faktik i tij është në shumën 151,082,680 lekë ose në masën 59%.

“Artikulli 601” - Buxheti i programuar në shpenzime “*Sig. shoqërore dhe shëndetësore*” për këtë program në fillim të vitit ishte në shumën 34,770,000 lekë. Buxheti i rishikur vjetor si rezultat i shtesës së fondit në shumën 1,500,000 lekë sikurse e kemi cituar më lartë, është në shumën 36,270,000 lekë, ndërsa realizimi faktik është në shumën 19,731,535 lekë ose në masën 54%.

Numri i punonjësve të KLGJ-së i miratuar me ligj për vitin 2024 është 138 punonjës ndërsa aktualisht në fund të muajit gusht në organikën faktike të KLGJ-së, rezultojnë 108 punonjës pra ka mungesë me 30 punonjës, që ka ndikuar në masën e realizimit të fondeve në shpenzime personeli.

“Artikulli 602” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për këtë program është në shumën 73,150,000 lekë, ndërsa realizimi faktik është në shumën 24,449,185 lekë ose në masën 33%, kundrejt planit të rishikuar vjetor. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të KLGJ-së me materiale e shërbime zyre, shpenzime për udhëtim e dieta si dhe janë kryer likuidimet e shpenzimeve të shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, energji elektrike, shpenzime mrëmbajtje dhe shpenzime të tjera speciale. Ndërkohë gjatë 8 mujorit për nevojat e stafit të KLGJ-së, vijon likuidimi i kontratave me objekt; "Shërbim printimi dhe fotokopjimi", "Shërbim larje automjetesh", "Shërbim mirëmbajtje automjetesh", "Pjesë këmbimi, goma, bateri për automjetet", "Shërbim mirëmbajtje paisje

audio - Sallë plenare", "Karburant", vlera e të cilave po likuidohet gradualisht gjatë vitit, në përputhje me kushtet kontraktuale. KLGJ-ja vazhdon procedurat e prokurimit.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individë*” për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2024, u detajua fondi në shumën 1,500,000 lekë. Fondi u planifikua kryesisht për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike, për përfituesit sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë” i ndryshuar. Fondit të detajuar në fillim të vitit në këtë artikull sikurse cituam më sipër ju shtua edhe ;

- Fondi i veçantë në shumën 1,200,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 1351/1, datë 23.02.2024.

- Fondi shtesë në shumën 1,506,000 lekë për pagësën e 2 pagave të funksionit për 2 ish anëtarët e KLGJ-së, miratuar nga MF me shkresën nr. 10738/1, datë 21.08.2024.

Buxheti i rishikuar vjetor në këtë artikull si rezultat i ndryshimeve të mësipërme është 4,206,000 lekë, ndërsa realizimi është në shumën 624,528 lekë, ose në masën 15% kundrejt planit të rishikuar vjetor.

Fondet në shpenzime korrente sipas buxhetit të rishikuar në shumën 370,265,000 lekë, janë realizuar në shumën 195,887,928 lekë ose në masën 53%. Realizimi në shpenzime korrente janë të lidhura me produktin kryesor të këtij programi; Produkti 92901AA - “Vendime të miratuara”. (Në formatin 2 dhe 3 sistemi reflektohet gabimisht produkti i vjetër “Auditime të kryera”, kurse tek formati 4 është pasqyruar saktë. Është diskutuar dhe pritet të sistemohet)

“Artikulli 231” - Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, në këtë program, është në shumën 15,000,000 lekë, i detajuar në dy produkte:

- **Produkti 23AC201** “Pajisje Software” në shumën 5,000,000 lekë, të cilat janë parashikuar të përdoren për sistemin Exchange Server për hostimin e e-maileve zyrtare në infrastrukturën IT, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të aktivitetit të KLGJ-së. KLGJ ka përfunduar procedurën, ka likuiduar fondin e kontraktuar në shumën 4,553,390 lekë, ose në masën 91% të fondit. Diferenca është tepriçë prokurimi online.

-**Produkti 23AC101** “Blerje mjete motorrike”- është detajuar fondi në shumën 10,000,000 lekë, për plotësimin e nevojave në automjete për ushtrimin e aktivitetit të KLGJ me 1 automjet. Është prokuruar dhe realizuar fondi në shumën 4,860,000 lekë për blerjen e 1 automjeti dhe teprica e fondit në shumën 5,140,000 lekë u riprokurua për blerjen e 2 automjeteve te tjera. Në total është prokuruar dhe realizuar fondi në shumën 9,828,000 lekë për blerjen e 3 automjeteve, ose në masën 98% e fondit të planifikuar.

Në total fondi në shumën 15,000,000 lekë në shpenzime kapitale në këtë program është realizuar në shumën 14,381,390 lekë, ose në masën 96%.

Realizimi i fondeve buxhetore për këtë program për 8 mujorin e vitit 2024, është në masën 55%. KLGJ vijon procedurat e prokurimit.

II- Programi - 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”

Fondi i detajuar në fillim të vitit si pjesë përbërëse e grupit buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, për këtë program është në shumën 16,800,000 lekë. Gjatë periudhës janar- gusht 2024, buxheti në këtë program është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në

shumën 100,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 1351/1, datë 23.02.2024. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë program është në shumën 16,900,000 lekë. Realizimi faktik për periudhën raportuese është në shumën 8,588,695 lekë ose në masën 51% kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor.

“Artikulli 600” - Buxheti vjetor i programuar në “*Shpenzime paga*”, për këtë program në fillim të vitit ishte në shumën 14,000,000 lekë. Buxheti i rishikuar në këtë artikull për këtë program është 12,150,000 lekë. Ndryshimi i buxhetit është i lidhur me rishpeërndarjen (pakësimin) e fondit në shumën 1,850,000 lekë nga artikulli 600 “Paga” dhe transferimin e këtij fondi në artikullin 602 “*Mallra dhe Shërbime të Tjera*”. Ministria e Financave me shkresën nr. 6112/1, datë 27.05.2024, ka miratuar kërkesën e KLGJ-së me shkresën nr. 2394 datë 29.04.2024. Realizimi faktik në paga është në shumën 6,883,942 lekë ose në masën 57% e buxhetit të rishikuar vjetor.

“Artikulli 601” - Buxheti i programuar në shpenzime “*Sig. shoqërore dhe shëndetësore*” për këtë program është në shumën 2,400,000 lekë, realizimi faktik është në shumën 1,044,753 lekë ose në masën 44%.

Numri i punonjësve të QTI-së i miratuar me ligj për vitin 2024, është 6 punonjës, ndërsa aktualisht janë punësuar vetëm 5 punonjës (Drejtori i QTI-së dhe 4 specialist), pra ka një mungesë me 1 punonjës, e cila ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“Artikulli 602” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për këtë program në fillim të vitit ishte në shumën 376,000 lekë. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së këtij fondi për vijim normal të aktivitetit të këtij institucioni deri në përfundim të vitit buxhetor, KLGJ me shkresën nr 2394, datë 29.04.2024 ka përcjellë në Ministrinë e Financave kërkesën për rishpërndarjen e fondit në shumën 1,850,000 lekë, nga artikulli 600 (paga) në artikullin 602 (mallra dhe shërbime të tjera). Ministria e Financave me shkresën nr. 6112/1, datë 27.05.2024, ka miratuar kërkesën e KLGJ-së. Buxheti i rishikuar në këtë artikull për këtë program është 2,226,000 lekë. Fondi është përdorur për kryerjen e shpenzimeve për pagesa “Honorare Bordi”, për anëtarët e Bordit Drejtues të QTI-së. Realizimi faktik në këtë artikull është në shumën 660,000 lekë ose në masën 30% e buxhetit të rishikuar vjetor.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit në “*Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë*” në shumën 24,000 lekë, do të përdoret kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare. Fondi është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën 100,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave. Gjatë 8 mujorit, fondi në shumën 124,000 lekë nuk është përdorur.

Fondet në këtë program janë të detajuara në shpenzime korrente dhe janë në funksion të produktit të vetëm të këtij programi që, është Produkti- 92903AA “Akte të miratuara”

Në formatin 2 dhe 3 të sistemit reflektohet gabimisht produkti i vjetër “programe dhe pajisje të STI” ndërsa në formatin 4 ai është pasqyruar saktë

III - Programi - 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Fondi i detajuar për këtë program në fillim të vitit 2024, në shumën 4,569,600,000 lekë, u rishikua si rezultat i akordimit të fondit në shumën 36,976,820 lekë nga të cilat:

- Akordimi i fondit të veçantë (Art.606) në shumën 3,200,000 lekë miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 1351/1, datë 23.02.2024.

- Shtesë fondi në artikullin 606 të programit 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shumën 276,820 lekë për likuidimin e 2 pagave të funksionit për një ish - magjistratë. Ministria e Financave ka miratuar me shkresën nr. 2661/1, datë 20.03.2024, kërkesën e KLGJ me shkresën nr. 1155/1, datë 27.02.2024.

- Shtesë fondi në shumën 33,500,000 lekë, në shpenzime paga (Artikulli 600). Fondi është i nevojshëm për mbulimin e efektit finciar si rezultat i ndryshimeve ligjore në paga në zbatim të VKM nr. 421 datë 26.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 325, datë 31.05.2024 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar. Miratuar nga Ministria e Financave me shkresën 9797/1 datë 30.07.2024, sipas kërkesës së KLGJ me shkresën 3647, datë 03.07.2024.

Buxheti i rishikuar vjetor është në shumën 4,606,576,820 lekë; nga të cilat 4,238,576,820 lekë në shpenzime korrekte dhe 368,000,000 lekë në shpenzime kapitale.

Realizimi faktik është në shumën 2,575,148,799.81 lekë ose në masën 56% i detajuar në 2,459,342,466.81lekë, në shpenzime korrente ose në masën 58% dhe 115,806,333 lekë ose në masën 32% në shpenzime kapitale.

Për periudhën janar-gusht 2024, gjykatat kanë realizuar shpenzime edhe nga të ardhurat e krijuara prej tyre. Në total janë kryer shpenzime nga të ardhurat në shumën 4,858,166 lekë, nga të cilat në shumën 3,785,375 lekë në mallra dhe shërbime (Art.602) dhe në shumën 1,072,791 lekë në shpenzime kapitale (Art 230+231).

Në mënyrë të detajuar për çdo artikull situata paraqitet si më poshtë:

“Artikulli 600” - Në “Shpenzime paga”, buxheti vjetor i planit për këtë program është në shumën 3,179,700,000 lekë. Gjatë vitit si rezultat i ndryshimeve ligjore në paga ky artikull u rishikua në shumën 33,500,000 lekë. Ministria e Financave me shkresën 9797/1 datë 30.07.2024, ka miratuar kërkesën për shtesë fondi në shumën 33,500,000 lekë i nevojshëm për mbulimin e efektit finciar të ndryshimeve ligjore në paga në zbatim të VKM 421 datë 26.06.2024, paraqitur nga KLGJ me shkresën 3647, datë 03.07.2024. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë artikull është 3,213,200,000 lekë, ndërsa realizimi për periudhën raportuese është në shumën 1,926,903,778 lekë, ose në masën 60% e buxhetit të rishikuar vjetor.

“Artikulli 601”- Buxheti fillestar i programuar në shpenzime “Sig. shoqërore dhe shëndetësore” për këtë program ishte 400,000,000 lekë, ndërsa realizimi për periudhën janar-gusht është në shumën 223,421,978 lekë ose në masën 56%.

Realizimi në këtë masë është i lidhur me mungesat në sistemin gjyqësor. Për vitin 2024, numri i punonjësve të miratuar me ligj për programin “Buxheti Gjyqësor”, është 1,615 punonjës nga këto; 408 janë magjistratë dhe 1,207 janë punonjës të administratës gjyqësore. Faktikisht në 30 gusht në strukturat organike të gjykatave rezultojnë 1,375 punonjës (311 magjistratë dhe 1,064 janë punonjës të administratës).

Aktualisht në gjykata ka mungesa në strukturën organike me 240 punonjës; nga të cilët 97 janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe 143 janë punonjës të administratës. Ndërkohë nga 311 magjistratë, që rezultojnë efektivisht në detyrë 72 prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhen me 75% të pagës.

“Artikulli 602” – Buxheti vjetor i alokuar për vitin 2024 në “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” është në shumën 615,800,000 lekë. Realizimi është në shumën 305,818,971.8 lekë, ose në masën 50%. Gjykatat gjatë kësaj periudhe, kanë shlyer detyrimet mujore për shërbime si energji elektrike, ujë, telefon, postë dhe shërbimin korrier. Janë likuiduar shpenzime transporti, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, shpenzime për udhëtim e dieta, shpenzime të tjera speciale si ekzekutime vendime gjyqësore, pagesa për ekspertë, avokatë, psikolog, etj.

Gjithashtu pjesë e fondeve buxhetore të artikullit 602 “Shpenzime operative” janë dhe disa shpenzime të cilat do të kryhen për të gjitha gjykatat dhe administrohen nga KLGJ-ja, të grupuara brenda të njëjtit program, në shumën 288,700,000 lekë, programi 03310 “Buxheti Gjyqësor” si më poshtë:

- Shërbim “Mirëmbajtje dhe zhvillime për sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore në gjykata, ICMIS ARKIT”, në shumën 83,600,000 lekë dhe **realizuar në shumë 34,570,226,lekë**.
- Shërbim “Mirëmbajtje e sistemit regjistrimit audio RDA dhe backup chain”, në shumën 6,500,000 lekë **dhe realizuar në shumën 3,644,760 lekë**.
- Shërbim, internet, intranet për sistemin gjyqësor, në shumën 15,000,000 lekë **dhe realizuar në shumën 8,639,554 lekë**.
- Shërbim, mirëmbajtje e programit financiar cloud, **është realizuar në shumën 2,198,281 lekë**.
- Shërbim për mirëmbajtje + licenca për rrjetin e klasifikuar, në shumën 600,000 lekë.
- Shërbim mirëmbajtje dhe zhvillime, për programin m-files, programin sdml lot + dhe portalin e-shërbime.klgj.al, në shumën 18,500,000 lekë **dhe realizuar në shumën 15,667,385 lekë**.
- Shërbim mirëmbajtje, sistemi i njoftimeve e-notification (për Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë), në shumën 3,000,000 lekë.
- Shërbim mirëmbajtje, regjistri i OJF-ve (për Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë), në shumën 2,900,000 lekë.
- Shërbim mirëmbajtje e sistemit Disaster Recovery në Këshillin e Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të kontratës së investimit, në shumën 500,000 lekë.
- Shërbim, test i penetrimit për përforcimin e sigurisë kibernetike në rrjetin dhe infrastrukturat IT të Gjykatave të Republikës së Shqipërisë, në shumën 47,600,000 lekë.
- Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes në gjykata, në shumën 105,000,000 lekë **dhe realizuar në shumën 60,729,613 lekë**.

Fondi në shumën 288,700,000 lekë është obliguar në shumën 238,994,460 lekë dhe është likuiduar deri tani fondi në shumën 125,449,819 lekë ose 43% e fondit të planifikuar vjetor.

KLJGJ vijon likuidimin e kontratave në përputhje më specifikimet e tyre teknike.

3. Në artikullin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, fondet buxhetore janë detajuar në shumën 6,100,000 lekë për kryerjen e kompesimeve të shpenzimeve të telefonisë celulare dhe pagesat e interesit të kredisë për blerje apartamenti për qëllime banimi për gjyqtarët, sipas parashikimeve ligjore dhe nën ligjore.

Fondi i akorduar në këtë artikull në fillim të vitit u rishikua në shumën 3,476,820 lekë si rezultat i dy ndryshimeve të bëra gjatë kësaj periudhe:

- Akordimi i fondit të veçantë për programin 03310, në shumën 3,200,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 1351/1, datë 23.02.2024.
- Shtesë fondit në programit 03310 “ Buxheti Gjyqësor”, në shumën 276,820 lekë për likuidimin e 2 pagave të funksionit për një ish - magjistrate. Ministria e Financave ka miratuar me shkresën nr. 2661/1, datë 20.03.2024, kërkesën e KLGJ me shkresë nr. 1155/1, datë 27.02.2024.

Buxheti i rishikuar vjetor në këtë artikull është në shumën 9,576,820 lekë, ndërsa realizimi për 8 mujor është në shumën 3,197,739 lekë, ose në masën 33%. Fondi i realizuar është përdorur në shumën 2,456,798 lekë për dhëniën e ndihmës së menjëhershme në raste të daljes në pension pleqërie apo sëmundje si dhe pagesa të telefonisë celulare për përfituesit, ndërsa diferenca e fondit të realizuar është përdorur në shumën 276,820 lekë për pagësën e 2 pagave kalimtare të 1 magjistrati dhe në shumën 464,121 lekë, për pagesat e shpenzimeve të interesave bankare.

Përveç fondeve buxhetore, gjykatat kanë realizuar edhe shpenzime nga të ardhurat në funksion të aktivitetit të tyre në shumën 3,785,375 lekë.

Fondet në shpenzime korrente sipas buxhetit të rishikuar vjetor në shumën 4,238,576,820 lekë janë realizuar në shumën 2,459,342,466.81 lekë, ose në masën 58%. Realizimi i tyre është i lidhur me Produktin nr. 1 - 92902AA “Çështje të gjykuara”.

“Artikulli 230+231” Buxheti në shpenzime kapitale (i cili është i planifikuar vetëm me financim të brendshëm) për programin 03310 për vitin 2024, në shumën 368,000,000 lekë është i detajuar në “Shpenzime kapitale të patrupëzuara” Artikulli 230, në shumën 28,000,000 lekë dhe në “Shpenzime kapitale të trupëzuara” Artikulli 231, në shumën 340,000,000 lekë.

Gjatë periudhës raportuese si rezultat i nevojave të gjykatave edhe pse në total nuk ka ndryshuar vlera e fondit të fondit në shpenzime kapitale, këto shpenzime kanë patur disa ndryshime brenda për brenda artikullit. Ka patur disa rishpërndarje që kanë sjellë ndryshime në vlerë për produkt apo edhe në sasi (numër institucionesh) për produkt si më poshte :

“Artikulli 230” - Buxheti vjetor i alokuar në “Shpenzime kapitale të patrupëzuara”, në shumën 28,000,000 lekë, ishte detajuar në fillim të vitit vetëm për 1 produkt.

Produkti - M290066 “Studime, Projektme, Kërkime” - Buxheti i miratuar për këtë produkt në programin 03310 të KLGJ-së, në shumën 28,000,000 lekë u programua në fillim të vitit për hartimin e projektit të zbatimit për ndërtimin e godinës së re për Gjykatën e Lartë. Realizimi i këtij fondi ishte i lidhur me gjetjen e sheshit të ndërtimit. Gjatë periudhës janar-gusht, është rishikuar ky fond pasi një pjesë e tij në shumën 6,850,000 lekë nga produkti M290066 “Studime, Projektme, Kërkime” të programit 03310 të KLGJ, u transferua (u rishpërnda) u shtuakodi i projektit M290066 “Studime, Projektme, Kërkime” për plotësimin

e nevojave të Gj.P.K.K.O. Kjo ka sjellë rishikim e numrit të institucioneve të planifikuar në këtë produkt nga 1 në 2 të tilla, pa ndryshuar vlera e tij. Fondi do të shërbejë për hartimin e 2 projekteve të zbatimit (për BMS dhe VRF), sistemit elektronik të ndërtesës dhe sistemit të ri ngrohje-ftohje, përfundimi i të cilëve i hap rrugë realizimit të tyre gjatë vitit 2025. Ministria e Financave me shkresën nr. 9448/1 datë 26.07.2024, ka miratuar transferim e fondit përcjellë me shkresën e KLGJ nr. 3539 datë 04.07.2024.

- Fondi në shumën 6,850,000 lekë për Gj.P.K.K.O, është transferuar në muajin gusht, kohë kur gjykata e ka të mbyllur aktivitetin e saj. Në muajin shtator gjykata ka filluar përgatitjen e dokumentacionit për realizimin e fondit.

- Fondi i mbetur i pashpërndarë në programin 03310 të KLGJ në shumën 21,150,000 lekë, nuk është përdorur pasi nuk ka patur zhvillime të reja lidhur me lejet për sheshet e ndërtimeve.

Fondi në artikullin 230 “Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara”, nuk është realizuar.

“Artikulli 231” - Buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit në “*Shpenzime kapitale të trupëzuara*”, për këtë program është në shumën 340,000,000 lekë, ndërsa realizimi për 8 mujorin është 115,806,333 lekë ose në masën 34%.

Fondi i detajuar në 5 produkte në fillim të vitit gjatë periudhës raportuese ka ndryshuar duke ndryshur vlerën e disa produkteve dhe numrin e institucioneve për produkt si më poshtë ;

I- Produkti - M290068 - “*Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm*”- Janë planifikuar në fillim të vitit fondet në shumën 113,900,000 lekë; nga të cilat për nevojat e 6 gjykatave është detajuar fondi në shumën 83,900,000 lekë, ndërsa diferenca e fondit në shumën 30,000,000 lekë do të administrohej nga KLGJ-ja. Gjatë periudhës janar –gusht ky produkt është rishikuar në sasi (numër institucionesh) dhe në vlerë. Fondi është rishikuar (shtuar) në shumën 3,800,000 lekë;

-Është shtuar (rishpërndarë) fondi në shumën 3,800,000 lekë për plotësimin e nevojave të Gjykatës së Lartë. Fondi i planifikuar në fillim të vitit në produktin 18AD801“Blerje orendi dhe pajisje zyre”, për Gjykatën e Lartë në shumën 3,800,000 lekë u transferua në produktin M290068 “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm”, të po kësaj gjykate. Fondi do të shërbejë për kryerjen e punimeve në nivel mirëmbajtje në ambientet e godinës së kësaj gjykate. Ministria e Financave me shkresën nr. 5284 datë 03.05.2024 ka miratuar këtë transferim, përcjellë nga KLGJ me shkresën nr. 2180 datë 17.04.2024.

-Rishpërndarë (pakësuar) fondi në kodin e projektit M290068 “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm” në administrim të KLGJ 03310, në shumën 16,192,000 lekë, dhe shtuar fondet në kodin e projektit M290068 “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm” në 03310, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në shumën 15,000,000 lekë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në shumën 340,000,lekë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në shumën 852,000 lekë. Ministria e Financave ka miratuar me shkresën nr. 9448/1 datë 26.07.2024 transferim e kërkuar nga KLGJ me shkresën nr. 3539 date 04.07.2024.

-Rishpërndarë (pakësuar) fondi në kodin e projektit M290068 “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm” në administrim të KLGJ 03310, në shumën 10,200,000 lekë, dhe shtuar fondi në kodin e projektit M290068 “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm” në 03310, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe

Krimit të Organizuar. Ministria e Financave me shkresën nr 10548/1 datë 06.08.2024 ka miratuar rishpërndarjen e kërkuar nga KLGJ me shkresën nr 3934/11 datë 30.07.2024.

Buxheti i rishikuar në këtë produkt si rezultat i ndryshimeve të sipërcituara është në shumën 117,700,000 lekë ndërsa numri i tyre ka ndryshuar nga 7 institucione të planifikuara në fillim të vitit në 12 gjykata (7+1+3+1). Për periudhën raportuese ky produkt nuk është realizuar. Është lidhur kontrata dhe obliguar fondi i Gjykatës së Lartë në shumën 2,965,222 lekë, likujdimi do të bëhet në muajt në vijim. Gjykata janë në proces prokurimi

2- Produkti - 21AC501- “Programe Software për gjykatat”, është detajuar fondi në shumën 116,100,000 lekë. Fondet në këtë projekt janë parashikuar të përdoren për disa projekte ekzistuese në vazhdim, në fushën e teknologjisë së informacionit, në Sistemin Gjyqësor, ndërsa 1 projekt është planifikim i vitit 2024 (Sistem Exchange Server). Produkti në shumën 116,100,000 lekë është kontraktuar fondi në shumën 115,870,331 lekë dhe është likujduar pjesërisht fondi në shumën 84,296,194.00 lekë, ose në masën 73%, sipas specifikimeve të kushteve kontraktore. KLGJ vijon likujdimet.

3- Produkti - 18AD801 “Blerje orendi dhe pajisje zyre”, janë detajuar fonde buxhetore në shumën 30,000,000 lekë, për blerjen e pajisjeve të zyrës si mobilje zyre, rafta arkive, sistem i fiksjes së zjarrit në arkiva, kondicioner dhe sistemin e ftohjes për dhomë serveri bateri serveri etj për nevojat e 11 gjykatave. Gjatë periudhës janar-gusht ky buxhet u rishikua në vlerë duke u pakësuar në shumën 3,800,000 lekë. Fondi i planifikuar në këtë produkt në fillim të vitit, për nevojat e Gjykatës së Lartë në shumën 4,500,000 lekë u pakësua në shumën 3,800,000 lekë dhe u transferua në produktin M290068 “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesëshëm” për plotësimin e nevojave të po kësaj gjykate. Ministria me shkresën nr. 5284 datë 03.05.2024 ka miratuar këtë transferim përcjellë me shkresë e KLGJ nr. 2180 datë 17.04.2024. Fondi i rishikuar në shumë 26,200,000 lekë është realizuar pjesërisht në shumën 1,510,139 lekë nga 5 gjykata, ndërsa 6 gjykatat e tjera janë akoma në proces.

4- Produkti - 21AC401 “Blerje pajisje për infrastrukturën elektronike”, janë detajuar fondet buxhetore në shumën 50,000,000 lekë. Fondet do të administrohen nga KLGJ në programin 03310, dhe është parashikuar të përdoret për plotësimin e nevojave në infrastrukturën e teknologjisë së informacioni (si server, sëitch, kompjuter, UPS serveri, UPS kompjuteri, printer, sisteme fonie, skaner, fotokopje, diktofon, harddisk, monitor etj) të 18 (tetëmbëdhjetë) gjykatave të tre niveleve. Është prokuruar, kontraktuar dhe obliguar fondi për nevojat e gjykatave në shumën 47,148,000 lekë. Likujdimi do të bëhet në muajt në vijim .

5- Produkti - M290075 “Blerje mjete motorike”, janë detajuar në programin 03310 të KLGJ-së, në shumën 30,000,000 lekë. Fondi u programua të përdoret për blerjen e 10 copë automjeteve, për përmirësimin dhe rinovimin e mjeteve të transportit në Sistemin Gjyqësor. Ka përfunduar prokurimi i 10 automjeteve dhe është likujduar vlera e kontraktuar në shumën 30,000,000 lekë, ose në masën 100%.

Fondi i planifikuar në shpenzime kapitale (Art 231), në këtë program, në shumën 340,000,000 lekë, është realizuar pjesërisht në shumën 115,806,333 lekë, ose në masën 34%.

Ndërsa në total fondi në shpenzime kapitale (Art 230+231) në shumën 368,000,000 lekë është realizuar në shumën 115,806,333 lekë, ose në masën 32%.

Gjatë 8 mujorit të parë të vitit përveç fondeve buxhetore në shpenzime kapitale gjykatat kanë realizuar shpenzime edhe nga të ardhurat në shumën 1,072,791 lekë.

Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve dhe realizimit të treguesve të performancës së programit (Aneksi 3,3/1 dhe 4).

I - Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Qëllimi kryesor për programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” është “Përmirësimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve që përbëjnë paketën e reformës në drejtësi si dhe sigurimin e burimeve dhe kapaciteteve financiare të nevojshme”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar objektivi: “KLGJ-ja do të angazhohet në vendosjen e standardeve të larta të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të saj si dhe për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të tre nivelet” me tregues performance:

1. Numri i akteve nënligjore të miratuara nga KLGJ-ja në masën 95%.
2. Përqindja e grave në poste drejtuese ndaj totalit të posteve drejtuese në KLGJ në masën 44%.
3. Numri i vlerësimeve etiko-profesionale të magistratëve në masën 67%.

Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 3 produktet e mëposhtme:

- Produkti 92901AA - “Vendime të miratuara” - Njësia matëse - “nr.vendimesh”.

Në fillim të vitit mbështetur në politikën e programit, objektivat dhe stafin, u planifikuan të miratohen rreth 500 vendime. Gjatë periudhës janar-gusht janë realizuar 485 të tilla. Produkti është realizuar në terma sasior në masën 97% e numrit të planifikuar, ndërsa në terma vleror realizimi në masën 53%. Për realizimin e këtyre vendimeve janë shpenzuar 195,887,928 lekë (që i referohen fondit në shpenzimeve korrente) ose janë shpenzuar mesatarisht 403,893 lekë/vendim. (në formatin 3.2 është akoma produkti i vjetër auditime të kryera).

- Produkti 23AC201- “Programe Software” - Njësia matëse – “nr. projektesh”.

Është detajuar fondi në shumën 5,000,000 lekë, për blerjen e projektit “Sistemin Exchange Server për hostimin e e-maileve zyrtare në infrastrukturën IT”, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të aktivitetit të KLGJ-së. KLGJ ka përfunduar realizimin e këtij produkti në shumën 4,553,390 lekë. Produkti është realizuar në terma sasior në masën 100 %, ndërsa në terma vleror realizimi është në masën 91%. Për realizimin e këtij produkti janë shpenzuar mesatarisht 4,553,390 lekë. Pra ka patur një kursim me 466,610 lekë, ose më e vogël në masën 9%.

- Produkti 23AC101 “Blerje mjete motorrike”- Njësia matëse – “nr. mjetelesh”

Janë detajuar fondet në shumën 10,000,000 mijë lekë, të cilat, u parashikuan të përdoren për plotësimin e nevojave në automjete për ushtrimin e aktivitetit të KLGJ me 1 automjet. KLGJ, ka përfunduar procedurën e prokurimit për blerjen e automjetit në shumën 4,860,000 lekë. Teprica e fondit u riprokurua dhe numri i automjeteve u rishikua në 3 të planifikuara dhe të realizuara. Fondi është realizuar në terma sasior në masën 100%, ndërsa në terma vleror në shumën 9,829,000 lekë ose në masën 98%. Pra për automjet është shpenzuar mesatarisht

3,333,333 lekë. Shpenzimet mesatare janë më të ulta në shumën 172,000 lekë ose në masën 2% .

II- Programin 01140 “Mbështetje për teknologjinë, e sistemit të drejtësisë ”

Programi buxhetor “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” ka për qëllim: “Përcaktimi i prioritetëve, politikave dhe standarteve, në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektiv “Angazhimi i QTI-së, për garantimin e arritjes së standardeve të BE-së për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit” me tregues performance:

Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë në masën 65%.

Për realizimin e këtij treguesi është planifikuar; Produkti 92903AA - “Akte të miratuara”.

